

09/08/2022

**VAZHDOJMË RRUGËTIMIN PËRGATITOR TË  
FJETJES SË HYJLINDËSES MARI, DUKE  
KRESHMUAR DERI MË 14 GUSHT (përfshirë edhe  
këtë datë)**



E Tërëshenja është “e bekuar ndër gratë” e cila u zgjodh “të lindë Shpëtimtarin e shpirtrave tanë”. Në kryqëzimin e Tij, Krishti e shpalli atë mistikisht nënë të të

gjithë njerëzimit, prandaj ajo përkujdeset dhe lutet pareshtur tek Biri i saj për të gjithë ne.

Prandaj çdo vit, Kisha Orthodhokse i kushton 14 ditë kreshme në nder të Hyjlindëses (dt.1-14 gusht, edhe dt 14). Kjo periudhë parapërgatitore kulmon në 15 gusht, ku kremtojmë Fjetjen dhe lindjen e saj në përjetësi, fitoren e jetës mbi vdekjen dhe kalimin në jetën e përhjetshme.

Pse kreshmojmë:

- \* Kreshma është periudhë ushtrimi shpirtëror, ushtrim i bindjes dhe ushtrim mohimi dëshirash.
- \* Kreshma na bën të vetëdijshëm për varësinë tonë tek Perëndia.
- \* Kreshma na ndihmon të krijojmë disiplinë personale.
- \* Kreshma është periudhë që zbulojmë nevojat tona të vërteta.

Si të kreshmojmë:

- \* Mbani kreshmë shenjtëruese.
- \* Kaloni më shumë kohë me Perëndinë gjatë Kreshmës.
- \* Kombinoni bamirësinë me kreshmën.
- \* Ruani një shpirt përulësie, pendimi dhe faljeje.
- \* Kreshmoni në fshehtësi.
- \* Kreshmoni me gëzim.

Rikujtojmë:

- Gjatë kreshmës nuk hamë ushqime me prejardhje shtazore (mish, vezë, bulmet, peshk) por hamë ushqime bimore (perime, fruta, brumera, vaj etj.)
- Konsumimi i peshkut lejohet vetëm më 6 gusht, të kremten e Metamorfozës së Shpëtimtarit.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)